

## Ofertat e kartës KiJu

Me kartën KiJu fëmijët dhe të rinjtë nga Singen mund të përdorin me zbritje të madhe ose pjesërisht edhe falas mbi 240 oferta të ndryshme nga mbi 80 shoqata, biznesmenë dhe institucione.

Larmia e ofertave nga fushat e mëposhtme patjetër përmban diçka për këdo:

**Sporti dhe lëvizja**

**Muzika**

**Kultura dhe koha e lirë**

**Kurse dhe arsimim**

**KiJu online**

**Shëndeti dhe mirëqenia**

**Natyra dhe mjedisi**

**Oferta pushimesh dhe kampingje**

**Ditëlindje fëmijësh**

**Zyra vullnetare për të rinjtë**

**Posaçërisht për më të vegjlit**

**Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara**

**Prindërit e rinj**

**Blerjet dhe tregjet**

**Gjithçka për biçikletën**

**Autobusi i qytetit Singen**

Informacione më të detajuara lidhur me ofertat jepen në broshurën gjithëpërfshirëse mbi kartën KiJu.

Broshura disponohet në të gjitha vendet e shpërndarjes ose online në [www.kiju-karte.de](http://www.kiju-karte.de).

## Kontakt

**Stadt Singen  
Soziale Leistungen**  
Petra Merklin  
Tel. 07731-85237  
[kiju-karte@singen.de](mailto:kiju-karte@singen.de)

**Kinderchancen e.V.**  
Alexandra Guldin  
Tel. 07731-96970550  
[guldin@kinderchancen-singen.de](mailto:guldin@kinderchancen-singen.de)

Na vizitoni në [www.kiju-karte.de](http://www.kiju-karte.de)



sq



SINGEN 

*Shërbimet sociale*

KiJu KARTA



Kinderchancen Singen e.V.



## Çfarë është karta KiJu?

Arsimi dhe pjesëmarrja në jetën sociale janë të rëndësishme për një zhvillim të shëndetshëm dhe për shanset e së ardhmes të fëmijëve dhe të rinjve. Prandaj, ofertat e larmishme të disponueshme në Singen nga fushat e sportit, muzikës, kulturës, arsimi dhe kohës së lirë duhet të jenë të aksesueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë fëmijët e qytetit Singen – pavarësisht nga të ardhurat e familjes.

Prandaj shoqata Kinderchancen E.v dhe qyteti Singen kanë krijuar së bashku kartën KiJu për familjet me të ardhura të pakta. Nëpërmjet rabateve tërheqëse ajo duhet të mundësojë më shumë pjesëmarrje. Në mënyrë që sa më shumë fëmijë dhe të rinj të kenë mundësi të përdorin kartën, shpërndarja bëhet pa probleme të mëdha burokratike në shumë vende të shpërndarjes.

Për kartën KiJu qyteti Singen ka vënë në dispozicion mjetet financiare nga buxheti i vet dhe në dy vitet e para ka marrë një subvencionim të landit Baden-Vyrtemberg nga programi „Akti vhe së bashku kundër varfërisë së fëmijëve dhe për shëndetin e fëmijëve“. Përveç kësaj, shumë shoqata, biznesmenë dhe institucione i mbulojnë vetë një pjesë të shpenzimeve.

Një falenderim nga zemra për të gjithë mbështetësit!



## Kush mund ta marrë kartën KiJu?

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë nga Singen dhe rrethinat nga mosha 0 deri 17 vjeç, prindërit e të cilëve marrin

### Përfitime sipas SGB II (paratë e qytetarëve)

ose

### Të ardhura bazë sipas SGB XII

ose

### • Para për banesë sipas WoGG

ose

### • Shtesë për fëmijë sipas nenit §6a BKGG

ose

### • Përfitime sipas Ligjit për trajtimin e azilkërkuesve

mund të kërkojnë një kartë KiJu.

**Ja si duket karta:**



## Ku dhe si mund të merret karta KiJu?

### Pak hapa për të marrë kartën KiJu:

1. Plotësoni kërkesën e thjeshtë
2. Paraqisni vërtetimin e përfitimeve
3. Tregoni kartën e identitetit të fëmijës

→ Karta KiJu lëshohet menjëherë dhe falas në emrin e fëmijës.

### Ku mund të merret karta KiJu:

Krahas vendeve zyrtare të shpërndarjes të referuara këtu ka edhe shumë institucione, të cilat e shpërndajnë kartën „brenda për brenda“. Thjesht pyetni në kopshtin ose shkollën tuaj.

### Qendra e qytetit

Soziale Leistungen - Erdgeschoss DAS 2  
Bürgerzentrum Singen - BÜZ  
inSi e.V.

Jugendreferat

Arbeiterwohlfahrt (AWO) Kreisverband Konstanz e.V.

• Kinderbüro

Tafel Singen - „Tafel Wegweiserin“  
Ev. Käthe-Luther Kinderhaus & Familienzentrum  
Caritasverband Singen-Hegau e.V.

Waldeck-Schule

Fachstelle Sucht

### Jugu i qytetit

Kinderchancen e.V.

KiTa St. Nikolaus mit Familienzentrum

Ev. Familienzentrum Markus

### Veriu i qytetit

Jugendtreff Nordstadt (JuNo)

Familienzentrum Im Iben

### Rrethinat

Ortsverwaltung: Beuren, Bohlingen, Friedingen,  
Hausen, Schlatt, Überlingen  
Grundschule Beuren